L I G J
Nr.7536, datë 17.12.l991

PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN E PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.l991 "Për dispozitat kryesore Kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në Kodin e Procedurës Penale, neni 1 ndryshohet si vijon:

"Përmbajtja dhe detyrat e legjislacionit procedural penal.

Legjislacioni procedural penal i Republikës së Shqipërisë shpreh vullnetin e popullit dhe ka për detyrë të mbrojë rendin kushtetues, të drejtat dhe liritë e njeriut, të parandalojë kryerjen e veprave penale dhe të ndikojë për edukimin e shtetasve me frymën e repektimit të ligjeve.

Legjislacioni procedural penal cakton rregulla për hetimin dhe gjykimin e drejtë e të shpejtë të çështjeve penale".

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Bazat dhe parimet e legjislacionit procedural penal

Legjislacioni procedural penal bazohet në dispozitat kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe i përmbahet parimit të ligjishmërisë, në bazë të të cilit organet e drejtësisë janë të detyruara të zbatojnë rregulla të njëjta e të barabarta për të gjithë, të bëjnë hetime e gjykime objektive të plota e të gjithanshme, me qëlllim që asnjë fajtor të mos i shmanget përgjegjësisë dhe të sigurohet çdo shtetas nga ndjekja e dënimi i padrejtë.

Legjislacioni procedural penal i përmbahet parimit të prezumimit të pafajësisë së të pandehurit ".

Neni 3

Neni 5 ndryshohet si vijon:

"Gjykata është organ që realizon dhënien e drejtësisë. Ajo gjykon me trup gjykues ose me një gjyqtar.

Për çështjet e kompetencës së tij, gjyqtari zbaton të gjitha rregullat që ky kod parashikon për gjykatën.

Askush nuk mund të deklarohet fajtor dhe të dënohet për kryerjen e veprës penale pa vendim gjyqësor.

Gjykata merr të gjitha masat për një gjykim të drejtë të çështjes, që të sigurohen në mënyrë sa më të plotë qëllimet e tij.

Gjykata, në gjykimin e çështjes penale, është e pavarur dhe vendos vetëm në bazë të ligjit".

Neni 4

Paragrafi i dytë i nenit 6 ndryshohet si vijon:

"Prokurori, në çështjet gjyqësore ku merr pjesë, ka për detyrë të mbrojë akuzat dhe interesat e përgjithshme të shoqërisë e të rendit juridik.

Neni 5

Në paragrafin e parë të nenit 38 hiqen fjalët "që përmban vlerësim politiko-shoqërorë të veprës".

Neni 6

Paragrafi i tretë i nenit 47 ndryshohet si vijon:

"Masat e sigurimit janë: 1) Detyrimi për moslargim, 2) dorëzania personale dhe pasurore, 3) mbyllja në shtëpi, 4) arrestimi".

Neni 7

Pas nenit 49 shtohet neni 49/a me këtë përmbajtje:

"Mbyllja në shtëpi është qëndrimi i detyrueshëm i të pandehurit në banesën e tij, me ose pa rojë.

Dorëzania personale është marrja e një deklarate të nënshkruar nga persona që meritojnë besim, ose ata bëhen dorëzanës që të paraqitin të pandehurin në hetuesi a në gjykatë sa herë që kërkohet. Kur i pandehuri i fshihet hetuesisë a gjykatës, kundër dorëzanësve jepen dënimet që parashikohen dëshmitarët që nuk paraqiten në bazë të nenit 203 të Kodit Penal.

Dorëzania pasurore është marrja nga një person fizik a juridik e një deklarate të nënshkruar, me të cilën ata detyrohen të paguajnë një shumë të caktuar, në rast se i pandehuri nuk paraqitet në hetuesi ose në gjykatë. Kur i pandehuri nuk paraqitet në hetuesi ose gjykatë, dorëzania pasurore shkon, me vendim të gjykatës, në dobi të shtetit".

Neni 8

Në nenin 57 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për veprat penale të kryera nga ushtarakët, hetimet bëhen nga organet e hetuesisë".

Neni 9

Paragrafi i parë i nenit 109 ndryshohet si vijon:

"Çështjet penale në shkallë të parë, me përjashtim të atyre që shqyrtohen nga një gjyqtar, shqyrtohen në Gjykatën e Lartë, në gjykatat e zonave, në gjykatat e rretheve e në gjykatat ushtarake nga një trup gjykues i përbërë nga një gjyqtar dhe dy ndihmësgjyqtar ".

Neni 10

Neni ll6 ndryshohet si vijon:

"Kompetencat lëndore e gjykatave të rretheve dhe e gjykatave ushtarake

Gjykatat e rretheve gjykojnë në shkallë të parë të gjitha çështjet penale, me përjashtim të atyre që me ligj janë lënë në kompetencën e gjykatave të zonave dhe të gjykatave ushtarake.

Gjykatat ushtarake gjykojnë në shkallë të parë veprat penale të kryera nga ushtarakët, si dhe veprat e tjera penale të parashikuara në dispozita të veçanta.

Gjykatat e rrethit dhe ato ushtarake gjykojnë me trup gjykues në shkallë të parë veprat penale, për të cilat ligji parashikon dënim me heqje të lirisë mbi 5 vjet.

Gjyqtari gjykon në shkallë të parë të gjitha kundëravajtjet penale, krimet, për të cilat parashikohen dënime me heqje të lirisë deri në 5 vjet ose dënime të tjera më të buta, si dhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në bazë të neneve l89, l90, 194, l95 dhe l96 të këtij Kodi".

Neni 11

Në nenin ll9 pas fjalëve "gjykatë zone" shtohen fjalët "ose gjykate ushtarake".

Neni 12

Në nenin 125 pas fjalës "akuzues" hiqen fjalët "për të cilat nuk është arritur pajtimi nga gjykata shoqërore", si dhe fjala "përsëri".

Neni 13

Në paragrafin e parë të nenit 127 shtohet neni 224 dhe hiqen nenet 237, 238, 239 e 240, kurse në pikën 5 të këtij neni shtohet fjalët "dhe akti i ekspertimit të armëve".

Neni 14

Në nenin 126, pas fjalës "akuzues" hiqen fjalët "kur nuk është arritur pajtimi nga gjykata shoqërore".

Neni 15

Paragrafi i parë i nenit 129 ndryshohet vi vijon:
"Në seancën përgatitore ka të drejtë të marrë pjesë prokurori, i cili duhet të lajmërohet".

Neni 16

Neni 142 ndryshohet si vijon:
"Personat që marrin pjesë në seancë gjyqësore, janë të detyruar të respektojnë rregullat që sigurojnë zhvillin normal të gjykimit.
Gjykata vendos largimin e të pandehurit ose të pjesëmarrësve në proces nga seanca gjyqësore pa e ndërprerë shqyrtimin, në rast se ata prishin rregullat e seancës dhe vazhdojnë të veprojnë në këtë mënyrë, me gjithë paralajmërimet që u bëhen.
Personat që qëndrojnë në sallë për të dëgjuar, kur shkelin rregullat, nxirren nga salla me urdhër të kryetarit. Me vendim të gjykatës këta persona mund të dënohen me gjobë deri në 500 lekë ose me heqje të lirisë gjer në l5 ditë. Vendimi i dhënë është i formës së prerë.

Neni 17

Nenet 2, 3, 53, l00, l06 paragrafi i fundit i nenit 127 paragrafi i katërt i nenit l79 dhe paragrafi i para i nenit l88, shfyqizohen.

Neni 18

Dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.97, datë 25.12.l991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.